



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 21 shkurt 2014, në mbledhjen e III-të (tretë) të Kuvendit.

Mbledhja filloi në orën 10. 05' dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç z. Florije Maliqi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, z. Agim Kikaj Nënkryetar i Komunës, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, thirrja dhe materiali i kësaj mbledhjeje është dërguar përmes postës elektronike më 11 shkurt 2014, mirëpo të nesërmen OJQ 'HANDIKOS' ka paraqitur një kërkesë për mbështetje financiare dhe duke qenë në dijeni për kushtet e tyre dhe në funksion të mosbllokimit të aktiviteteve të tyre, Kryetari i Komunës në konsultim me mua në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit, jemi marr vesh që kjo çështje të procedohet për përfshirje në rend dite.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i Kryesuesit të Kuvendit që në rend dite të Përfshihet:

Propozimi i Vendimit për mbështetje financiare OJQ – në Handikos – Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi në Podujevë

z. Kadri Avdiu, shtroi pyetje, sa është në rregull të shqyrtohen njëmbëdhjetë pika të rendit të ditës duke e llogaritur edhe pikën e rendit të ditës e cila u miratua pak më parë, dhe të merren vendime ende pa u konstituuar trupat e Kuvendit, pra a është kjo në përputhshmëri me dispozitat ligjore.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me çështjet të cilat janë propozuar në rend të ditës, paraprakisht jemi konsultuar me Zyrën Ligjore dhe duke u bazuar se nuk ka të bëjë me çështje të mëdha financiare, me planifikim apo ndonjë çështje për të cilën është i autorizuar të shqyrtoj Komiteti për Politikë dhe Financa, nuk kemi parë ndonjë problem për shqyrtimin dhe miratimin e çështjeve të propozuara.

z. Flakron Gashi, theksoi, nga rendi i propozuar i ditës shihet se preken disa çështje pronësore, atëherë pse ne si asamblast nuk kemi asnjë informatë sa i përket çështjes së

ndërtimit të obeliskut të Heroit Afrim Zhitia , sipas kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të datës 1 nëntor 2013 nr. i protokollit 4026/2013, drejtuar z. Mehmet Gashit, drejtor i atëhershëm i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit i cili tashmë është Kryesues i Kuvendit dhe z. Abaz Llugaliut, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, pra përse ne nuk kemi asnjë informatë sa i përket krijimit të kushteve të cilat i ka kërkuar Ministria e cekur për të filluar punimet përkatëse. Lidhur me këtë, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së propozoj që çështja e ndërtimit të obeliskut të Heroit Afrim Zhitia të përfshihet në rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, çështja e ngritur nga parafolesit ka të bëjë me pikën e rendit të ditës të ndryshme ku mund të shtrohen kërkesa, të bëhen pyetje apo të kërkojnë informata të ndryshme, për të cilat ekzekutivi është i obliguar që të jap përgjigje në mbledhjen e radhës.

z. Kadri Avdiu, theksoi, propozimi i z. Flakron Gashit ishte që çështja e propozuar të përfshihet si pikë e veçantë e rendit të ditës, e jo të futet në të ndryshme, andaj propozimi duhet të vëhet në votim, a do të miratohet apo jo është çështje tjetër.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, parafolesit i'u përgjigj, në bazë të përvojës që kam jam në dijeni se nuk mundet të përfshihet një çështje në rend dite pa e përcaktuar propozuesi materialin përkatës. Përndryshe unë nuk jam i informuar për kërkesën zyrtare të Ministrisë së cekur, përveç disa bisedave lidhur me këtë çështje.

z. Flakron Gashi, theksoi, kërkesën të cilën e ngrita e bazoj në dokumente zyrtare, dhe e ceka numrin e protokollit, datën e kërkesës dhe kujt i është dërguar.

Sa i përket informatave, në kërkesën e cekur janë konkretizuar, hapësira dhe planimetria e kompleksit, andaj unë si dëshmi mund t'ua jap personave përgjegjës që ta fotokopjojnë dhe t'ua shpërndajnë këshilltarëve.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, do të ishte mirë që propozuesi të sqarojë përse propozimin përkatës e bënë në mbledhjen e sotme, cili është qëllimi i propozimit që të përfshihet në rend dite dhe pastaj ne mund të sqarohemi.

Sa unë jam në dijeni, është kërkesë për rritjen e sipërfaqes për obeliskun e Heroit Afrim Zhitia, mirëpo ky Kuvend, më parë, ka marrë vendim dhe i ka ndarë mbi 4 ari, atëherë ashtu ka qenë kërkesa. E ceka se tash ka ardhur kërkesa për rritjen e hapësirës përkatëse, mirëpo nuk kemi informacione zyrtare nga asnjë Ministri se çfarë do të punohet në atë hapësirë. Në anën tjetër e kemi një kundër kërkesë apo petition me nënshkrime të banorëve të atij lokaliteti të cilët kërkojnë që Komuna të mos merr vendim për rritjen e hapësirës përkatëse, nga kjo ne e kemi një situatë të pasqaruar, andaj nuk është mirë që ditën e sotme ky Kuvend të shqyrtoj këtë çështje dhe të implikohet në këto probleme pa u sqaruar situata dhe pa e dhënë mendimin Drejtoritë e Komunës të cilave i'u është bërë kërkesa. Përndryshe Drejtoritë janë duke e shqyrtuar atë kërkesë, kanë pasur takim edhe me grupin e banorëve të cilët kanë bërë petition, andaj ne në radhë të parë duhet të sqarojmë disa gjëra e mos t'i fusim njerëzit në konflikt me vendbanimet tona, ngase nuk kemi nevojë të shkaktojmë konflikte, përndryshe as ata të cilët e kanë dhënë jetën për këtë vend nuk e meritojnë që për shkak të një obelisku apo çfarëdo projekti të futen në konflikt banorët e një fshati apo lagjeje.

Unë kërkoj prej të gjithë këshilltarëve mirëkuptim që sot kjo çështje të mos përfshihet në rend dite, dhe në ndërkohë Drejtoritë përkatëse të japin përgjigjet e tyre dhe pasi të

marrim këto përgjigje ne mund të shqyrtojmë këtë çështje në një prej mbledhjeve të ardhshme të Kuvendit.

z. Kadri Avdiu, theksoi, për çështjen për të cilën po debatohet, Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës kanë qenë të informuar, kërkesa nuk është shtruar nga Grupi jonë i Këshilltarëve por është shtruar nga Ministria kompetente tek organet e Komunës.

Kryetari i Komunës tha se nuk e dijmë se çfarë mund të bisedojmë sot, mirëpo jam në dijeni se më parë sipas kërkesës janë ndarë 4 ari për këtë qëllim e tash bëhet fjalë për rritjen e asaj sipërfaqeje që është e qartësuar në kërkesë. Në rastin konkret bëhet fjalë për pronën e Komunës e jo për pronë private, andaj pasi nuk ka të bëjë me pronë private, unë nuk jam në dijeni se çfarë konflikti mund të shkaktojmë ne, pra qëllimi jonë është të mos humbin mjetet e destinuara për këtë qëllim nga ana e Ministrisë përkatëse. Pra nga ne varet a dëshirojmë të përshpejtojmë realizimin e atij projekti apo jo.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, Kryetari Komunës shumë mirë e sqaroi se së pari kërkesën e cekur duhet ta shqyrtoj Ekzekutivi, e përgatitin materialin dhe pas kësaj kjo çështje mund të shqyrtohet në Kuvend.

Kërkesën të cilën ma dorëzoi z. Flakron Gashi, e cila figuron në emrin tim në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, me përgjegjësi e them se atë kërkesë nuk e kam pranuar por për përmbajtjen e saj jam i informuar përmes bisedave të ndryshme.

z. Naim Çunaku, theksoi, kur filluam të debatojmë për propozimin e rendit të ditës dolën dy propozime shtesë dhe atë propozimi i parë i z. Kadri Avdiut, shef i Grupit të këshilltarëve të PDK-së, propozim shumë i arsyeshëm i cili konsiston në atë se vihet në pikëpyetje se nëse miratohen çështje të caktuara pa u themeluar trupat punues të Kuvendit të Komunës, andaj konsideroj se në mbledhjen e sotme Kuvendi të themeloj Komitetet përkatëse, ndërsa çështjet tjera të shqyrtohen në një mbledhje tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit tha se e kam lexuar Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale përkatësisht kompetencat e Komiteteve dhe se çështjet e propozuara për shqyrtim nuk kanë komplikime të mëdha, sa është e arsyeshme a kanë komplikime të mëdha apo të vogla, çdo komplikim është komplikim pavarësisht a është i madh apo i vogël, andaj unë e përshëndes propozimin që nga rendi i ditës të hiqen të gjitha pikat me përjashtim të themelimit të Komiteteve të përhershme.

z. Haki Rudari, theksoi, jam i interesuar të dijë se kur ka ardhur kërkesa e Ministrisë përkatëse në Drejtorinë Komunale, përndryshe Grupi i këshilltarëve i LVV-së e përkrah në parim idenë e këshilltarit – kolegut për rritjen e hapësirës së obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, e besoj se edhe ju të gjithë e përkrahni në parim këtë ide ngase fjala është për një personalitet të madh i cili ka kontribuar mjaft shumë.

Megjithatë duke u bazuar në gjendjen e krijuar jam i mendimit se duhej të jepet një pauzë prej 15 minutash në mënyrë që të konsultohen grupet e këshilltarëve, të sqarohen çështjet dhe të vazhdohet me punë. Përndryshe nëse vazhdohet në formën e këtillë jam i mendimit se vetëm do të krijohen divergjenca në votimin për rendin e ditës.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, nuk pajtohem me mendimin se ky Kuvend nuk mund të miratoj vendime pa themelimin e Komiteteve ngase fundja Komitetet mund të bëjnë rekomandime por Kuvendi nuk është i obliguar t'i miratoj ato rekomandime, pra Kuvendi është organi më i lart në Komunë, mund të miratoj vendime me apo pa rekomandime, andaj kjo nuk është arsye që pikat e propozuara të hiqen nga rendi i ditës, por nëse ju mendoni se çështjet e propozuara janë shumë të ndjeshme mund të vendosni

që ato pika të mos shqyrtohen në mbledhjen e sotme, mirëpo përveç tjerash janë dy kërkesa, thënë të drejtën, i kemi propozuar në rend dite nën presionin e disa fermerëve të cilët kanë përfituar në një projekt të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, çështje të cilat nuk kanë mundur të shqyrtohen deri në konstituimin e Kuvendit, pra çështja ka të bëjë me atë që ata fermerë të mos i humbin donacionet nga Ministria përkatëse.

sa i përket kërkesës për Handikos nuk mendoj se asnjë prej këshilltarëve do të votoj kundër ndarjes së mjeteve buxhetore për kategorinë e cekur që në bazë të kërkesës së tyre është propozuar shuma prej 14,784.00 €, e cila për një vit i mbulon aktivitetet e tyre, kjo çështje është kompetencë e këtij kuvendi, me Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere është e përcaktuar se subvencionet mbi 10,000.00 €, i ndan Kuvendi e jo Komiteti për Politikë dhe Financa. Konsideroj se nuk ekziston asnjë arsye që këto pika të hiqen nga rendi i ditës, për këtë ju jeni ata që vendosni, mirëpo nëse hiqen rrezikohen dy kërkesat e fermerëve që janë mjetet e ndara të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa OJQ-së Handikos një pjesë e aktiviteteve i'u shtyhet për një kohë.

Sa i përket obeliskut të Heroit Afrim Zhitia edhe një herë po e theksoj, asnjë prej nesh nuk është kundër zgjerimit të hapësirës dhe realizimit të projektit përkatës, por jam i mendimit se kjo çështje duhet të sqarohet ngase në kohën kur ne e kemi pranuar kërkesën për rritjen e hapësirës, menjëherë ka ardhur kundër kërkesa me nënshkrime, ne e posedojmë atë peticion, andaj konsideroj se është e nevojshme që unë në cilësinë e Kryetarit të Komunës së bashku me drejtorët e Drejtorive përkatëse të zhvillojmë biseda me ata njerëz dhe të arrijmë një marrëveshje në mënyrë që njerëzit të mos futen në konflikt ngase unë e kam vërejtur se situata atje nuk është e pa acaruar.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, Kryesuesi i Kuvendit e përmendi se lidhur me propozimet e vendimeve të kryetarit të Komunës është konsultuar edhe Zyra ligjore, mirëpo propozimet e vendimeve janë në kundërshtim me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale përderisa nuk themelohen Komitetet. Sa i përket obeliskut të Heroit Afrim Zhitia jam i mendimit se 15 apo 20 nënshkrime në peticionin e cekur nuk janë përcaktuese as për lokalitetin përkatës, Komunën e as për Kuvendin, ngase çdo lokalitet i ka përfaqësuesit në këtë organ.

Konsideroj se Kryesuesi i Kuvendit do duhej ta hedhë në votim çështjen e obeliskut dhe në mënyrë demokratike këshilltarët mund të përcaktohen për apo kundër, është e vërtetë se kërkesa është te Drejtoritë përkatëse, pa e përcaktuar se përgjegjësi e cilit drejtor ka qenë, pra kërkesa është e protokolluar dhe e arkivuar, mirëpo kjo kërkesë nuk është shqyrtuar, ne nuk po e marrim se kjo është bërë në mënyrë tendencioze, së paku unë, por jam i mendimit se Kryesuesi i Kuvendit ka obligim moral që nëse miratohet rendi i ditës me pikat e propozuara, edhe përkundër asaj se nuk janë themeluar Komitetet, atëherë në rend dite të përfshihet edhe çështja e obeliskut ngase mjetet janë ndarë nga niveli qendror dhe është duke u pritur vetëm zgjerimi i hapësirës, e kjo i bënë nderë edhe lokalitetit edhe neve.

Po e shfrytëzoj rastin për me ua uruar Ditën e Pavarësisë ngase është dobësi e Kryesuesit të Kuvendit që nuk e thirrur seancën solemne për ditën tonë më të rëndësishme ngase ka qenë moment sublimi, gjithashtu nuk është përfillur Udhëzimi qeveritar për mbajtjen e seancës solemne. Është e vërtetë që edhe unë edhe Kryetari

nuk e kemi pasur një shtatore për me vendosur lule, por i kemi vizituar disa varreza nëpër fshatra, mirëpo mendoj se vitin e ardhshëm kjo legjislaturë të ketë mundësi që kursorat t'i vendos në vendin e duhur, për arsye se një vend i tillë nuk ekziston në qytetin tonë e për këtë ndihemi keq të gjithë.

z. Kadri Avdiu, theksoi, e mbështesë kërkesën e Grupit të këshilltarëve të LVV-së, këtë e bëjë duke u bazuar në sqarimet e Kryetarit të Komunës, andaj pajtohem që të jepet një pauzë në mënyrë që të konsultohen Grupet e këshilltarëve dhe pastaj të vazhdohet me punë.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, në parim propozimi lidhur me obeliskun e Heroit Afrim Zhitia duhet të mbështetet, mirëpo pas sqarimeve, neve, si Grup i këshilltarëve, na krijoi dilemë dhe tani është vështirë të merret një qëndrim konkret, andaj konsideroj se është e nevojshme një pauzë për konsultime ose ekzekutivi të paraqet materialin e nevojshëm dhe kjo çështje të jetë pikë e veçantë e rendit të ditës në një mbledhje të ardhshme.

z. Islam Revuçi, theksoi, çështjet i kemi të rregulluara me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, andaj është obligim o jonë të veprojmë në pajtim me aktet e cekura.

Rendi i propozuar i ditës u lexua, ku pati propozime të reja nga këshilltarët, andaj do duhej që propozimet konkrete të vehen në votim, dhe nëse marrin shumicën e votave sistemohen në rend dite, nëse jo atëherë vazhdohet me punë më tutje.

Çështja e dytë të cilën dëshiroj ta them është, Kryetari i Komunës e sqaroi se ne jemi Kuvend dhe kemi përgjegjësi ndaj qytetarëve, përveç kësaj Kryetari i Komunës e ka një përgjegjësi të madhe në aspektin ligjor ngase Kryetari i Komunës është i obliguar që përmes mekanizmave përkatës çështjet të cilat në kundërshtim me aktet të cilat përcaktojnë punën e Kuvendit të mos i lejoj të vehen për shqyrtim në Kuvend.

Çështja e tretë, vendimet të cilat janë propozuar për miratim në mbledhjen e sotme e kanë edhe një instancë tjetër që e bënë mbikëqyrjen e funksionalizimit të pushtetit lokal e që është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe kemi raste që nuk e kanë marrë vizën vendimet përkatëse, andaj nuk do duhej të marrim rolin e dikujt tjetër që nuk e kemi obligim ta marrim.

z. Naim Çunaku, theksoi, edhe Kryetari i Komunës edhe të gjithë këshilltarët e Kuvendit afërsisht kush më shumë e kush më pak, janë të njoftuar me Ligjet dhe procedurat e funksionimit e Kuvendit. Propozimi i parë kishte të bëjë me atë që nëse ky Kuvend vendos pa kaluar propozimet e vendimeve nëpër trupat e Kuvendit, pra pa u konsoliduar Kuvendi, vendos me marr vendim, a do të jetë i ligjshëm ai vendim apo jo. Përndryshe vlerësimin e ligjshmërisë të vendimeve nuk e bënë Kryetari i Komunës por Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Është e ditur se Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës bashkërisht e propozojnë rendin e ditës, këtu nuk ka asgjë të keqe, mirëpo u përmenden Statuti i Komunës dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe sipas tyre çdo këshilltar i Kuvendit të Komunës e ka të drejtën të propozoj çështje për të cilat është i mendimit se duhen të përfshihen në rend dite.

Nga debatet e deritanishme është krijuar një situatë e cila imponon një pauzë në mënyrë që shefat e Grupeve të këshilltarëve së bashku me Kryesuesin e Kuvendit t'i harmonizojnë qëndrimet ngase nëse vazhdohet në këtë formë ndokush do të ndjehet humbës për diçka që askush nuk duhet të ndihet humbës.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, kur ka të bëjë me vendime lidhur me dëshmorët e Kombit që nuk janë të partive politike, unë propozoj të mos i politizojmë në këtë Kuvend, por të

koordinohemi mirë me një projekt konkret në mënyrë që projekti i propozuar të mos vëhet i papërgatitur.

Dëshmorët e Kombit janë ata që na kanë prurë në këtë ditë, andaj ne nuk guxojmë të bëjmë lojëra politike në këtë formë.

z. Islam Revuçi, theksoi, unë e përcaktova fazën deri kur Kryetari i Komunës ka të drejtë me tërheqë ndonjë propozim vendim, kjo është e para ajo që dua të them, dhe së dyti, askush nuk është kundër propozimit përkatësisht pikës së rendit të ditës për obeliskun e Dëshmorit Afrim Zhitia mirëpo jemi për atë që e tha parafolësi që këtë çështje mos ta politizojmë, që unë plotësisht e mbështesë, por jemi edhe për atë që të mos vijmë në një situatë që të thuhet se këshilltarët e LDK-së votuan kundër, ngase shumë më mirë është që të përgatitet materiali dhe të vendoset kjo çështje.

Pauzë 25 minuta,

Fillimisht u konstatua se ekziston kuorumi përkatësisht janë të pranishëm shumica e këshilltarëve.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, me shefat e grupeve të këshilltarëve e mbajtëm një takim mjaft të frytshëm dhe gjetëm gjuhë të përbashkët dhe morëm qëndrim që Kuvendit t'i propozohet për heqjen e dy pikave të propozuara në rend dite, përkatësisht:

- Propozimi i Vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Sipas kërkesave të Smajl Isufit – Majac dhe Fexhri Sylës-Gllamnik).
- Propozimi i Vendimit për lejimin e shpërndarjes së masës drusore për djegie të konfiskuara për shkak të prerjes pa leje.

Ndërsa lidhur me çështjen e obeliskut të Heroit Afrim Zhitia u morëm vesh që Drejtoria përkatëse të përgatitë një informatë detaje dhe në një prej mbledhjeve të ardhshme të debatohet si pikë e veçantë e rendit të ditës.

Gjithashtu ne u morëm vesh që fillimisht të bëhet dhënia e betimit e dy këshilltarëve e më pastaj të vazhdohet me punë me pika përkatëse sipas renditjes të rendit të ditës.

Pas votimit u konstatua se rendi i ditës i propozuar pas konsultimeve të Kryesuesit të Kuvendit me shefat e Grupeve të këshilltarëve u miratua njëzëri

2. Verifikimi i Mandatit dhe dhënia e betimit e dy Këshilltarëve të Kuvendit

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, të nderuara këshilltare dhe këshilltarë, pas dhënies së dorëheqjes së parevokueshme të ish këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës z. Agim Kikaj i emëruar tani Nënkryetar i Komunës dhe z. Fatmir Gashit i emëruar drejtor i Drejtorisë së Administratës, është iniciuar kërkesa për zëvendësimin e tyre dhe me vendimet përkatëse të Komisionit Qendror të zgjedhjeve dhe në vend të tyre këshilltarë të kuvendit janë emëruar z. Shaban Osmani dhe z. Avni Ajeti. Edhe pse emërimi i të përmendurve është bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në nenin 35 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale parashihet që “ Mandati i çdo këshilltari të Kuvendit të Komunës verifikohet nga Komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga Kuvendi i Komunës “ , në pajtim me këtë dispozitë është e nevojshme

të ngritët Komisioni për verifikimin e mandateve, lidhur me këtë propozoj që përbërja e këtij Komisioni të jetë e njëjtë me përbërjen e ngritur në mbledhjen konstituive përkatësisht anëtarë të jenë z. Naim Çunaku dhe z. Haki Rudari me ndryshim që në vend timin LDK – ja të propozoj një anëtar tjetër.

A pajtoheni me këtë propozim

z. Naim Çunaku, theksoi, lidhur me përbërjen e këtij Komisioni propozoj që në vendin tim të jetë z. Flakron Gashi.

Grupi i këshilltarëve të LDK – së propozon z. Afrim Shabanin, dhe

Nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së mbetet ai i njëjti, z. Haki Rudari

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim dhe ngritët Komisioni për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit, në këtë përbërje:

1. Afrim Shabani
2. Flakron Gashi, dhe
3. Haki Rudari

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e ftoj Komisionin që të bëjë verifikimin e mandatit të këshilltarëve, dhe pas verifikimit të paraqet raportin përkatës.

z. Haki Rudari, theksoi, Komisioni në përbërje të plotë verifikoi dhe konstatoj se në bazë të Vendimit nr. 206-2014 të datës 30 janar 2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, z. Shaban Osmani emërohet këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës nga radhët e subjektit politik LDK, duke zëvendësuar z. Fatmir Gashin nga subjekti politikë përkatës, dhe në bazë të Vendimit nr. 207-2014 të datës 30 janar 2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, z. Avni Ajeti emërohet këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës nga radhët e subjektit politik LDK, duke zëvendësuar z. Agim Kikajn nga subjekti politikë përkatës.

Në emër të Komisionit të lartcekur i'u uroj dy këshilltarëve të cekur suksese dhe punë të mbarë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, fillimisht i rikujtoj për procedurat e dhënies së betimit dhe ftojë zotërinjtë Shaban Osmanin dhe Avni Ajetin të përgatiten për dhënien e betimit solemn.

Betimin e dhanë:

z. Shaban Osmani dhe

z. Avni Ajeti

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, urime tani jeni zyrtarisht këshilltarë të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

3. Miratimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit të Komunës më 15 janar 2014.

Ekstrakti i procesverbalit u miratuan njëzëri.

4. Propozimi i vendimit për themelimin e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, afërsisht para dy javëve kemi mbajtur një konsultim me përfaqësues të Grupeve të këshilltarëve me përjashtim të AAK-LDD, lidhur me strukturën e trupave të Kuvendit dhe në atë takim plotësisht jemi pajtuar me strukturën përfaqësuese të të gjitha Komiteteve përveç Komitetit për Politikë dhe Financa, ku kanë qenë disa dilema për të cilat më konkretisht do të flasim pjesëmarrësit në atë konsultim.

z. Islam Revuçi, theksoi, me qëllim të lehtësimit, sa më kujtohet mua me 8 shkurt të këtij viti ke biseduar lidhur me strukturën e Komiteteve dhe për shumë çështje kemi rënë në dakord.

Propozimi i LDK-së është që në Komitetin për Politikë dhe Financa të përfaqësohet me 6 anëtar, ky ka qenë qëndrim nga takimi i cekur konsultativ të cilin e kam paraqitur në Grupin e këshilltarëve të LDK-së ku është mbështetur dhe ka marr formën e propozimit në përbërjen e cekur më parë, mirëpo është e ditur se për këtë vendos Kuvendi. Sa për sqarim unë jam i autorizuar të flas për këtë pikë të rendit të ditës ngase kam qenë pjesëmarrës në takimin e cekur, mirëpo nuk jam i zgjedhur shëf i Grupit të këshilltarëve të LDK-së

z. Naim Çunaku, theksoi, është e vërtetë se përfaqësuesit e subjekteve, përjashtuar AAK-LDD e kanë mbajtur një takim konsultativ - përfaqësues ku kemi arritur një marrëveshje dhe ajo marrëveshje është në formën e shkruar dhe të gjithë pjesëmarrësit në atë takim e kanë marr nga një kopje dhe një prej atyre kopjeve të marrëveshjes është kjo që e kam unë në dorë. Në atë takim prej LDK-së të pranishëm kanë qenë Kryesuesi i Kuvendit, dhe këshilltarët z. Islam Revuçi e z. Fidan Rekaliu, prej PDK-së z. Kadri Avdiu dhe unë, ndërsa prej LVV-së z. Bahri Selimi, pastaj përfaqësuesi i OSBE-së dhe të Zyrës ligjore dhe marrëveshja e arritur, që kemi menduar se do të del si propozim para Kuvendit është se ne në bazë të një formule të përbërjes së Kuvendit duke qenë në dijeni se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të gjitha Komitetet dhe Komisionet të themelohen në bazë të përfaqësimit të subjekteve politike në Kuvend dhe duke e pasur parasysh vullnetin e qytetarëve përkatësisht ulëseve të subjekteve politike në Kuvend, ne kemi arritur një marrëveshje në përpjesëtim të drejt dhe të saktë që në çdo tre këshilltar të jetë një anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, pra LDK-ja prej 15 këshilltarëve 5 anëtar, PDK-ja prej 12 këshilltarëve 4 anëtar, LVV-ja prej 3 këshilltarëve 1 anëtar dhe të AAK-LDD prej 3 anëtarëve 1 anëtar, mirëpo kur kemi ardhur te AAK-LDD është ngritur dilema se a kanë apo nuk kanë grup të këshilltarëve dhe në një formë të pranishmit në atë takim kanë kërkuar që bisedimet të vazhdojnë në mes të LDK –së dhe AAK-LDD dhe të arrijnë një marrëveshje të përbashkët se si do të jetë përfaqësimi i AAK-LDD-në Komitetin për Politikë dhe Financa. Kjo që e thash ka krijuar një pikëpyetje por në asnjë mënyrë nuk është thënë se LDK-ja të ketë 6 anëtarë, përse do t'i ketë 6 anëtarë jo se ne nuk dëshirojmë apo ndokush tjetër por për atë se duhet respektuar rezultatin e zgjedhjeve.

Në atë takim kemi pasur zëra se Kryesuesi i Kuvendit është zgjedhur me 18 vota dhe se kjo duhet të merret në konsideratë, mirëpo nëse këshilltarët përkatës deklarohen se i bashkëngjiten grupit të këshilltarëve të LDK-së atëherë mund të flitet për numër tjetër, mirëpo në bazë të asaj se LDK-ja i ka vetëm 15 këshilltarë ne konsiderojmë se kjo është formula për të cilën jemi marrë vesh që ka qenë në formë të shkruar dhe nga një kopje iu dhënë të gjithë pjesëmarrësve.

Marrëveshja e arritur nuk ju obligon juve, mirëpo ne konsiderojmë se kemi arritur marrëveshje dhe qëndrojmë pranë asaj marrëveshjeje.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, jam në dijeni për takimin konsultativ që e keni mbajtur, mirëpo konsideroj se as ju e as të tjerët nuk keni të drejtë të flisni për Grupin e AAK-së, e nëse kemi diçka zyrtare është mirë të na informoni. Përndryshe kjo çështje në mënyrë të kristalizuar është e përcaktuar në nenin 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ku thuhet “Përbërja e Komiteteve duhet të reflektoj përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës. LDK dhe AAK-LDD nuk kanë kurrfarë marrëveshje ngase AAK-LDD nuk ka çfarë t’i falë askujt, ne kemi qenë në një proces zgjedhor dhe i kemi rezultatet që i kemi, AAK-LDD sipas rezultateve të zgjedhjeve është subjekti i tretë dhe mbi këtë bazë kërkon hisen e vetë. Sipas vendimit që është në fuqi, Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet prej 11 anëtarëve dhe duke u bazuar në entitetet politike nuk është e zorshme të caktohet përfaqësimi përkatës.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, e mbështes propozimin e parafolësit ngase nuk ka nevojë të diskutohet ajo çështje meqë AAK-LDD duhet ta ketë dhe do ta ketë përfaqësuesin e vet në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në asnjë variant nuk do të lejohet që atë vend t’a zënë ndonjë subjekt tjetër apo ndokush të llogaritet në përqindjen e votave të AAK-LDD-së, për arsye se ne jemi partia e tretë për nga numri i votave në nivel të Komunës.

z. Bahri Selimi, theksoi, në takimin konsultativ që e kemi mbajtur kemi arritur një marrëveshje për të cilën nuk duhet diskutuar shumë ngase ajo është në formë të shkruar e cila u është shpërndarë të gjithë pjesëmarrësve. Nuk jam në dijeni për propozimin që bëhet në bazë të asaj se a ka apo nuk ka një subjekt Grup të këshilltarëve, mirëpo në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në takimin e mbajtur, pas diskutimeve jemi marrë vesh për numrat e përfaqësimit dhe kemi marrë proporcionin e barabartë të përfaqësimit të këshilltarëve në Komitetet e Kuvendit dhe atë me rezultate të sakta, pa presje. Në atë takim është paraqitur dilema se AAK-LDD a ka apo nuk ka Grup të këshilltarëve, është thënë se nëse merret vesh me këtë subjekt, LDK mund të ketë 6 anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa, përndryshe nëse AAK-LDD është Grup i këshilltarëve duhet të mbetet proporcioni LDK - 5, PDK - 4, LVV-1 dhe AAK-LDD-1.

z. Mrika Thaçi, theksoi, po e vërej se këshilltarët e AAK-së janë duke kërkuar që në Komitetin për Politikë dhe Financa të përfaqësohen me një anëtar, nëse jeni Grup i këshilltarëve nuk kam asgjë kundër që ta keni një anëtar në këtë Komitet, mirëpo deklaroj se nga ky moment deri në një moment të caktuar nuk jam pjesë e AAK-LDD-së, pra nuk i takoj Grupit të këshilltarëve të këtij subjekti ndërsa në këtë Kuvend jam këshilltarë e pavarur dhe do të votoj sipas vlerësimit tim.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, duhet pasur parasysh se Kryesuesi i Kuvendit që është Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa, nuk hynë kurrfarë përpjesëtimi dhe mbi këtë bazë është paraqitur propozimi që LDK-ja të ketë 5+1.

Përndryshe në atë takim është paraqitur dilema se AAK-LDD nëse ka grup të këshilltarëve ta ketë një anëtar në Komitetin e cekur, në të kundërtën ai anëtar do t’i takoi LDK-së.

z. Naim Çunaku, theksoi, nuk kisha dëshiruar që diskutimi im të krijoj konfuzitet, apo paqartësi, unë në diskutimin e mëparshëm e thash atë çfarë ka ndodhur në takimin konsultativ dhe e tregova marrëveshjen.

Është e vërtetë se Kryesuesi i Kuvendit edhe në atë takim e ka potencuar se ai si kryesues të mos llogaritet si përfaqësues i subjektit përkatës, atë rast e kam thënë dhe po e them

edhe tash, në atë moment që Kryesuesi i Kuvendit të distancohet prej subjektit që i përket dhe është i pavarur, ne do ta pranojmë plotësisht atë që thotë kryesuesi, por derisa Kryesuesi i Kuvendit është pjesë e një grupimi politik, mbetet ashtu siç e thash.

Në mënyrë të hapur, të qartë dhe shumë fer e kemi thënë që në atë moment që Grupit të këshilltarëve të LDK –së, prej 15 këshilltarëve, i bashkohet në formë të shkruar apo në formë gojore ndonjë këshilltar i subjekteve të tjera, ne nuk kemi se si të mos e respektojmë dhe llogarisim atë veprim, mirëpo unë nuk jam në dijeni se ka ndodhur diçka e këtillë.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, unë jam i mendimit se përfaqësimi në Komitete është i përcaktuar me ligj dhe Rregullore përkatëse, mirëpo në atë takim ju jeni dakorduar që për çdo 3 këshilltarë duhet të ketë 1 anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa, kjo është matematikë e thjeshtë që nëse ju jeni dakorduar që në çdo 3 këshilltarë vie një anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, atëherë LDK-së me 15 këshilltarë i takojnë 5 anëtarë, por nëse i bashkëngjiten edhe 3 këshilltarë i takojnë 6 anëtarë, mirëpo në bazë të gjendjes aktuale ku AAK-LDD është subjekti i tretë në nivel të Komunës së Podujevës gjithsesi i takon një anëtar në Komitetin e cekur.

z. Fidan Rekalii, theksoi, jam i interesuar të dijë se AAK-LDD a ka apo nuk ka grup të këshilltarëve, nëse jo atëherë LDK-së i takojnë 6 anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa, përndryshe në takimin konsultativ jemi marrë vesh që nëse ndonjë këshilltar i bashkëngjitet LDK-së, do të ketë 6 anëtar në Komitetin e cekur.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, është shumë e qartë se ju keni diskutuar në emër të Grupeve të këshilltarëve dhe është po ashtu e qartë se z. Mrika Thaqi këtu ka ardhur me votën e AAK-së, andaj AAK-ja dhe z. Mrika kanë përgjegjësi për votuesit e tyre, mirëpo e drejta e secilit prej nesh është që të përcaktohet sipas vullnetit të tij.

U tha se jemi pajtuar që në çdo 3 këshilltar të vie një anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, ne jemi në dijeni se e keni mbështetjen e z. Nexhat Llumnicës, LB, por edhe nëse e keni mbështetjen e z. Mrika Thaqi, këta duhet të deklarohen se i bashkëngjiten subjektit politikë LDK e cila i ka 15 këshilltarë në këtë Kuvend, kjo është fuqia e votës dhe nuk mund të kalkulohet me numra të tjerë. Jam i mendimit se kjo legjislaturë nuk është mirë me filluar mbledhjet dhe punën me një qasje të keqe siç ka filluar prej mbledhjes së parë me vazhduar me miratimin e vendimeve të jashtëligjshme.

LDK mund të ketë 6 anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa vetëm nëse arrin t'i bëjë 18 këshilltarë, qoftë edhe nëse i bashkëngjitet ndokush nga subjekti im, unë do ta përshëndes.

z. Kadri Avdiu, theksoi, folëm të gjithë pjesëmarrësit e takimit konsultativ të mbajtur afërsisht para javëve, dhe unë tash habitem përse ne u thirrëm në atë takim, përse biseduam dhe përse u konsultuam, unë jam i mendimit se këtë e kemi bërë vetëm për të mos zgjatur mbledhja e Kuvendit. Për atë që jemi marrë vesh e kemi në formë të shkruar duke filluar nga Kryesuesi i Kuvendit e deri tek unë, ju veproni si të dëshironi dhe ndryshoni ato që merremi vesh paraprakisht, unë jam në dijeni se keni presione, por edhe në atë takim kemi thënë se numri i këshilltarëve të subjekteve politike është vullneti i qytetarëve dhe janë të rreshtuar, LDK, PDK, AAK-LDD, LVV dhe përgjegjësinë para këshilltarëve e ka çdo këshilltarë që është këtu, pavarësisht a është në pozitë apo në opozitë dhe atë që e thotë z. Agim Kikaj, është nënkryetari i Komunës, nuk është këshilltarë dhe nuk ka nevojë por as të drejtë me ndërhy në çështje të Kuvendit, mirëpo mund ta thotë mendimin e vet kur paraprakisht i jepet fjala nga Kryesuesi.

Në atë takim i keni kalkuluar dy forma, së pari se Kryesuesi nuk duhet llogaritur dhe së dyti keni thënë, nëse AAK – LDD nuk ka Grup të këshilltarëve dhe dy prej tyre votojnë në favor tonin atëherë ne do të kemi 6 anëtar në Komitetin për Politikë dhe Financa, në atë rast kam thënë nëse ju me 1,2 apo 3 këshilltarë arrini marrëveshje, atëherë ne këtë do ta respektojmë. Mirëpo unë nuk e kuptoj se çfarë i prish punë legjislativit që të përfshihen të gjitha subjektet politike në mekanizmat e Kuvendit, a është negative apo pozitive, unë jam i mendimit se largimi i një subjekti është negative.

z. Agim Kikaj, nënkryetar i Komunës, theksoi, dëshiroj të bëjë vetëm një sqarim, unë nuk ndërhyra në punën e Kuvendit, për të mos marr këtë minutash të vogël thash se me 18 vota është zgjedhur Kryesuesi i Kuvendit, mirëpo nuk duhet të luajmë me çështjen e këshilltareve apo këshilltarëve që i kemi kolegë, është e drejtë e tyre të përcaktohen për këtë apo për atë grup, ndërkaj është legjitime secili me siguruar shumicën në bazë të asaj që e thotë ligji, jashtë asaj nuk mund të dalim.

Është hipokrizi, qoftë prej meje qoftë prej kujt do të thuhet po i shmangim partitë, edhe ti edhe unë përfaqësojmë interesa të grupacioneve të caktuara politike, secili grupacion përpiqet në suaza të kapaciteteve që i ka dhënë elektorati, me imponuar politikën edhe këtu në Kuvend dhe për çështje konkrete me gjet mirëkuptim, por kur nuk ka mirëkuptim duhen numrat e votave, nuk është e dëshirueshme por është e fundit.

Përndryshe kryeson Komitetin për Politikë dhe Financa në kapacitetin e Kryesuesit të Kuvendit dhe nuk i ka 15 vota por i ka 18 vota të këshilltarëve, e cilat janë ato vota ka qenë e fshehtë.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, unë e kuptoj se në baza ligjore qafë kandidat për këshilltar të Kuvendit të Komunës, votat i ka marrë në emrin e tij personal, pak më par z. Mrika Thaqi u deklarua se nuk është pjesë e AAK-së, andaj i ka marrë edhe votat të cilat i ka fituar në emrin e saj persona.

Unë jam këshilltarë i këtij Kuvendi nga radhët e subjektit politikë Lëvizja për Bashkim dhe e mbështesë LDK-në.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, pas deklarimit të zonjës Thaqi, është një fakt i ri, dhe ajo si këshilltare e Kuvendit do të funksionoj si e pavarur. Zonja Thaqi e shfrytëzoi të drejtën e saj ligjore që mandatin e vet ta trajtoj si të pavarur, mirëpo në fakt veprimi i cekur e zbehë përfaqësimin në Kuvend por nuk e zbehë forcën politike të AAK-së e cila në zgjedhjet e fundit lokale ka marrë 9% të votave të elektoratit të Komunës së Podujevës. Unë në cilësinë e bartësit të listës i kam 3153 dhe nëse z. Mrika Thaqi i bartë votat e veta, votat e mia nuk mund t'i bartë. Në fund, insistoje edhe një herë se edhe dy vota të AAK - LDD-së në mënyrë absolute shkojnë në favor të asaj siç e parasheh ligji për përfaqësimin e etniteteve politike e që sipas një parallogaritjeve që e bëra duhet të jemi, 5 anëtarë nga LDK-ja, 4 anëtarë nga PDK-ja, 1 anëtarë AAK - LDD-ja dhe 1 anëtarë LVV, dhe votat tona shkojnë për këtë propozim.

z. Bahri Selimi, theksoi, në takimin konsultativ është arritur një marrëveshje që sipas mendimit tim duhet t'i përmbahemi, mirëpo edhe nëse nuk i përmbahemi asaj marrëveshjeje sërish sipas disa kalkulimeve nuk na lejojnë të dalim jashtë formulës për të cilën jemi marrë vesh.

U përmenden 18 vota me të cilat është zgjedhur Kryesuesi i Kuvendit, kushdo prej këshilltarëve duke përfshirë edhe të opozitës ka mundur individualisht me ja dhënë votën z. Mehmet Gashit, kjo është e drejtë e çdo njërit edhe pse vota ka qenë e fshehtë e njësoj është edhe nëse do të ishte e hapur, pra këtë nuk mund ta kontestoj askush. Mirëpo nuk

do të thotë se nëse ndokush e ka votuar z. Gashin që e ka merituar të jetë Kryesues në rastin përkatës se do ta votoj prapë në projekte të tjera, andaj është mirë që të flasim me numra konkret e jo me numra të fryrë sipas dëshirës apo sipas asaj që na bie më mirë. Përndryshe numrat konkret të këshilltarëve janë, 15, 12, 3, 3, 1, 1 dhe derisa nuk ka asnjë kalim zyrtar të ndonjë këshilltari nga një subjekt në subjektin tjetër politik, jam i mendimit se na duhet t'i përmbahemi rezultateve zgjedhore.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, qëllimi i takimit konsultativ ka qenë që ti përafrojmë qëndrimet në mënyrë që në Kuvend të dalim me propozime konkrete, mirëpo bazuar në debatet e deritanishme unë konstatoj dy propozime dhe atë, i pari është që në Komitetin për Politikë dhe Financa LDK t'i ketë 6 anëtarë, PDK 4 anëtarë dhe LVV 1 anëtarë, dhe propozimi i dytë është përbërja 5 anëtarë LDK, 4 anëtarë PDK, 1 anëtarë LVV dhe 1 anëtarë AAK – LDD, andaj e hedhim në votim propozimin e parë.

z. Naim Çunaku, theksoi, takimi konsultativ është mbajtur, është arritur marrëveshje konkrete, andaj konsideroj se së pari duhet të vihet në votim propozimi sipas marrëveshjes e më pastaj propozimi që LDK t'i ketë 6 anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa, përndryshe marrëveshja nuk ka të bëjë vetëm me propozimin e strukturës së Komitetit të cekur por ka të bëjë me strukturën e të gjitha Komiteteve të Kuvendi.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, jam i bindur se nuk kemi çfarë të bisedojmë për këtë çështje ngase numrat e këshilltarëve janë të qartë, andaj kërkesa e AAK –së dhe shumicës së opozitës e në këtë rast konsideroj se është dashtë të jetë kërkesë edhe e pozitës sepse është kërkesë reale meqë AAK, me rezultate zgjedhore është e treta në nivel të Komunës dhe derisa është partia e tretë nuk mundet me ju tjetërsuar vendi i përfaqësuesit në Komitetin për Politikë dhe Financa, ndonjë partie tjetër përderisa nuk i ka 18 këshilltarë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e vuri në votim propozimin që në Komitetin për Politikë dhe Financa LDK – ja të ketë 6 anëtarë, PDK – ja 4 anëtarë dhe LVV –ja 1 anëtarë

pas votimit u konstatua se 17 vota ishin për, 17 vota ishin kundër dhe asnjë votë e përmbajtur.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se propozimi u miratua duke u bazuar në dispozitat ligjore për rastet kur votimi është i barabartë, përkatësisht në votën shtesë të Kryesuesit, ndërsa emrat e anëtarëve, subjektet politike t'i dërgojnë në Zyrën ligjore në afat prej 3 ditësh.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, meqë po vazhdohet praktika e kontrabandimit të votave, që është e drejtë e juaja, dhe meqë Grupi juaj i këshilltarëve nuk i respekton ligjet që e rregullojnë këtë fushë, ne këshilltarët e AAK-së jemi të detyruar ta lëshojmë mbledhjen dhe më mos të marrim pjesë më në këtë takim.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, vendimi u miratua me votat e këshilltarëve andaj unë lidhur me mospajtimin e parafolësit nuk kam kurrfarë komenti.

z. Kadri Avdiu, theksoi, më herët shpreha mendimin se nuk duhet të lajmë anash një subjekt politik, mirëpo këmbëngulësia e juaj ishte propozimi përkatës të vihet në votim ngase keni llogaritur se votimi do të jetë i barabartë 17 për, 17 kundër, por jeni bazuar në votimin shtesë apo dy votat e Kryesuesit të Kuvendit, andaj kërkoj nga Grupi i këshilltarëve të PDK –së dhe opozitës në tërësi ta lëshojnë mbledhjen ngase nuk

pranohet në format e këtilla dhe me diktat, me qenë se nuk e vure në votim propozimin që jemi marr vesh por veproni krejt mbrapsht.

z. Haki Rudari, theksoi, nuk e kam pritur një gjendje të këtillë ngase kam menduar se do të mbizotëroj respekti dhe se do të jetë një përbërje aktive e Kuvendit, përbërje e cila nuk do të fokusohet në interesin partiak por do të jetë përbërje e cila do të përqendrohet në interesin e qytetarëve.

Ne si Lëvizje jemi të përfaqësuar me 3 këshilltarë dhe ku është interesi i qytetarëve do të kemi votën e këtij subjekti, mirëpo në gjendjen e krijuar konsiderojmë se nuk është mirë të vazhdohet me punë sipas pikave të rendit të ditës pasi që një pjesë e kolegëve tanë kanë braktisur mbledhjen.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, duke u bazuar se në mbledhje ishin të pranishëm vetëm 17 këshilltarë, përkatësisht se nuk ekzistonte kuorumi e ndërpreu mbledhjen me konstatim se vazhdimin e mbledhjes do ta thërret kur të krijohen kushtet.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15'

Vazhdim i mbledhjes së ndërprerë më 21 shkurt 2014

Vazhdimi i mbledhjes u mbajt më 13 mars 2014, në sallën e Kuvendit, duke filluar nga ora 10.00'

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, z. Agim Kikaj Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive Komunale, z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para se të fillojmë me punë dëshiroj t'ju njoftoj, ju me siguri jeni në dijeni se në mbledhjen e mbajtur më 21 shkurt 2014 është miratuar rendi i ditës dhe më pastaj është ndërprerë mbledhja, por tani është e nevojshme se mbledhjen duhet ta vazhdojmë me ato pika të miratuara ku disa janë miratuar, dhe ta përfundojmë mbledhjen. Unë si Kryesues i Kuvendit e kamë parë të arsyeshme të ftoj shefat e Grupeve në një takim dhe jemi marr vesh që ta përfundojmë atë mbledhje me ato pika të miratuara të rendit të ditës, po ashtu ju njoftoj se një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa ku të gjitha ato pika, krahas diskutimeve po thuajse njëzëri, i kemi rekomanduar Kuvendit për miratime, për çka edhe i falënderoj anëtarët e KPF –së, për më tepër i keni në Konstatime të cilat posa i morët.

Kam një vërejtje, sepse ju jeni në dijeni se në mbledhjen e kaluar ne i kemi shkelur në disa raste procedurat e Rregullores së Punës së Kuvendit, lidhur me diskutimet, e them këtë vetëm sa për t'ju përkujtuar ngase me siguri se shumica prej jush jeni në dijeni se mbledhjet e Kuvendi të Komunës incizohen dhe përcillen edhe nga Ministria e

Administrimit të Pushteti Lokal. Andaj pa humbur shumë kohë mund të vazhdojmë me punë përkatësisht me pikën e radhës që është, propozimi i vendimit për themelimin e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit, përveç Komitetit për Politikë dhe Financa i cili është themeluar me vendim në mbledhjen e kaluar. Andaj për këtë nëse pajtoheni, propozoj që të votojmë në tërësi për të gjitha Komitetet dhe Komisionet e kuvendit dhe për përbërjet e tyre, meqë disa subjekte i kanë propozuar kandidatët e tyre lusim ato subjekte të cilat nuk e kanë bërë këtë t'i propozojnë kandidatët e tyre sipas rekomandimeve të KPF-së, e m pastaj ta hedhim në votim.

z. Naim Çunaku, theksoi, nga ajo që Kryesuesi i Kuvendit paraqita para nesh propozimet gjegjësisht anëtarët e Komiteteve dhe Komisioneve të cilat duhet të themelohen sot dhe që kanë qenë si pika të rendit të ditës në seancën e kaluar, një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa ne kemi vazhduar dhe qëndrojmë pranë asaj që kemi pasur një marrëveshje paraprake edhe para se të na ndodh ajo që ndodhi në atë seancë, dhe formula të cilën e lexoi Kryesuesi i Kuvendit dhe i Komitetit për Politikë dhe Financa është ashtu, ne Partia Demokratike e Kosovës në mbledhjen e KPF-së nuk i kemi dhënë emrat dhe pasi që Kryesuesi i Kuvendit i propozoi apo më mirë të them si e mori të drejtën që t'i propozoi kandidatët nga radhët e subjektit politikë LDK, për Komitete dhe Komisione përkatëse, unë në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së në vazhdim do t'i japë emrat e kandidatëve të propozuar nga radhët e PDK-së.

- Në Komitetin për Komunitete, propozoj z. Xhevdet Beselicën
- Në Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ku PDK-ja udhëheqë me këtë komitet propozoj z. Edon Malokun – kryetar dhe z. Florije Maliqin anëtare
- Në Komitetin për Arsim dhe Kulturë, propozoj z. Hilmi Hoxhën dhe z. Fatmir Rudarin
- Në Komitetin për Zhvillim Ekonomik, propozoj z. Xhevdet Beselicën dhe z. Valon Hotin
- Në Komitetin për Planifikim Urban Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, propozoj z. Rafet Llapashticën dhe z. Fahri Osmanin.

z. Haki Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve të subjektit politik të Lëvizjes Vetëvendosje për anëtarë të Komiteteve dhe komisioneve të Kuvendit sipas rekomandimeve të nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, propozon;

- Në Komitetin për Komunitete, z. Bahri Selimi
- Në Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z. Adelinë Stublla
- Në Komitetin për Arsim dhe Kulturë, Haki Rudari
- Në Komitetin për Zhvillim Ekonomik, Adelinë Stublla, dhe
- Në Komitetin për Planifikim Urban Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, propozojmë, z. Bahri Selimin.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk ka asnjë propozim për Komitetet dhe Komisionet tjera të Kuvendit të cilat ju i propozoni për arsye se në mbledhjen e kaluar ju hodhët në votim dhe votuat për përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa për kundër asaj që ne u tërhoqëm vërejtjen se jeni duke vepruar në kundërshtim me Ligjin, mirëpo kjo gjë nuk ju bëri përshtypje dhe ju morët një veprim të tillë që ne konsiderojmë se e keni shkelur edhe parimin e demokracisë. Prandaj në kontekst të kësaj ne nuk kemi propozime për anëtar të Komiteteve dhe Komisioneve të cekura dhe njëkohësisht kërkoj nga Shërbimi i Kuvendit që asnjë dokument të këtyre Komiteteve dhe Komisioneve të mos ma përcjellin sepse për mua ato nuk janë legjitime.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, duke ju përgjigjur parafolësit shtoi, vetëm dua t'ju përkujtoi se kjo është e drejtë e juaja mirëpo ligjshmërinë e vendimeve dhe akteve tjera ligjore e bëjnë organet kompetente përkatësisht Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, andaj unë e hedh në votim këtë propozim për themelimin e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit.

Pas votimit u konstatua se me 34 vota për, 1 votë të përmbajtur dhe asnjë votë kundër, u miratua propozimi i vendimit për themelimin e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit në këtë përbërje:

- Komiteti për Komunitete

Shaban Osmani, anëtar nga radhët e LDK-së
Xhevdet Beselica, anëtar nga radhët e PDK-së
Bahri Selimi, anëtar nga radhët e LVV-së
Shaban Ahmeti, anëtar nga radhët e Komunitetit ashkalinj
Xhafer Ademi, anëtar nga radhët e Komunitetit ashkalinj
Mefail Rama, anëtar nga radhët e Komunitetit rom
Radisav Perović, anëtar nga radhët e Komunitetit serb

- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Edon Maloku, kryesues i Komitetit, nga radhët e PDK-së
Floriqe Maliqi, anëtare nga radhët e PDK-së
Zaim Thaçi, anëtar nga radhët e LDK-së
Ismet Jashari, anëtar nga radhët e LDK-së
Afërditë Lutfiu, anëtare nga radhët e LDK-së
Adelinë Stublla, anëtare nga radhët e LVV-së
_____, anëtar nga radhët e AAK-LDD

- Komiteti për Arsim dhe Kulturë

Kdrije Mulolli, kryesuese e Komitetit, nga radhët e LDK-së
Selmon Hoti, anëtar nga radhët e LDK-së
Nusret Ismajli, anëtar nga radhët e LDK-së
Hilmi Hoxha, anëtar nga radhët e PDK-së
Fatmir Rudari, anëtar nga radhët e PDK-së
Haki Rudari, anëtar nga radhët e LVV-së
Jahë Lahu, anëtar nga radhët e komunitetit pakicë

- Komiteti për Zhvillim Ekonomik

Agron Hyseni, kryesues i Komitetit, nga radhët e LDK-së
Avni Shabani, anëtar nga radhët e LDK-së
Hasan Softolli, anëtar nga radhët e LDK-së
Xhevdet Beselica, anëtar nga radhët e PDK-së

Valon Hoti, anëtar nga radhët e PDK-së
Adelinë Stublla, anëtar nga radhët e LVV-së
_____, anëtar nga radhët e AAK-LDD

- Komiteti për Planifikim Urban Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

Rafet Llapashtica, kryesues i Komitetit, nga radhët e PDK-së
Fahri Osmani, anëtar nga radhët e PDK-së
Fatlume Jaha, anëtare nga radhët e LDK-së
Muhamet Maloku, anëtar nga radhët e LDK-së
Shaban Azemi, anëtar nga radhët e LDK-së
Bahri Selimi, anëtar nga radhët e LVV-së
_____, anëtar nga radhët e AAK-LDD

5. Propozimi i Vendimit për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, ne edhe një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës dhe në parim i kemi rekomanduar Kuvendit për miratim të këtij propozim vendimi.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, është e vërtetë ajo që e tha Kryesuesi se ne në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës. Në atë mbledhje është thënë se Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në mandatin e kaluar ka marr mirënjohje për punën e vet, unë dua që para se të konsolidohet ky Këshill në përbërje të re për këtë mandat duke i'u referuar Udhëzimit Administrativ përkatës, gjegjësisht nenit 9 pika 1.1 i cili thotë se brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi përmes mediave publike ftohen komunitetet përkatëse për t'i bërë propozimet e përkatëse të anëtarëve të tyre në këtë Këshill, pasta në pikën 1.7 thuhet, prezantimi i planit vjetor të punës në Kuvendin Komunal për miratim, është dashur të dimë, edhe pse është kaluar kjo, se ky Këshill a e ka prezantuar planin vjetor të punës në Kuvendin Komunal për miratim në mandatin e kaluar, informimin e Kuvendit dy herë brenda një viti për aktivitetet e Këshillit gjë për të cilën më shumë janë në dijeni këshilltarët e Kuvendit që kanë qenë edhe në mandatin e kaluar, gjithashtu procesverbalet të futen në dosje dhe të jenë të disponueshëm për të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës nëse me kërkesë të tyre kërkohen ato, Komuna të publikoj në ueb-faqen e saj zyrtare procesverbalet nga takimet e këtij këshilli, andaj nëse ky Këshill ka marr mirënjohje për punën e vet jemi të interesuar të dimë se a i ka kryer të gjitha këto detyra që i përmenda dhe që kërkohen me ligj, dhe kërkoj që Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë mandat t'i respektoj këto pika që të jenë të diskonim për këshilltarët e Kuvendit në mënyrë që të merr edhe një mirënjohje më të madhe se ajo që e ka marr në mandatin e kaluar.

Gjithashtu para konsolidimit të KKSB-në kamë edhe një kërkesë, që për përfaqësuesin e OJQ-ve, për atë të Mediave, për atë Bizneseve dhe për atë të FSK-së, Kryesuesi i Kuvendit të na e paraqet bazën e delegimit të tyre dhe procesverbalet e mbajtjes së takimeve për delegim të tyre për përfaqësim në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.

z. Haki Rudari, theksoi, ne në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa jemi pajtuar në parim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për arsye se parashihet dhe rregullohet me Udhëzim Administrativ përkatës, mirëpo një çështje të cilën e kemi ngritur në atë takim dëshiroj ta ngris edhe sot këtu, neni 4 i Udhëzimit e parasheh përbërjen e KKS-së e duke u bazuar në këtë ne kemi një vërejtje meqë ky Këshill themelohet në këtë Kuvend dhe ne si këshilltarë të këtij Kuvendi duhet të jemi në dijeni se peroni i ranguar me numrin 4 në propozim vendimin për themelimin e KKS-së, a është qytetar i Komunës tonë dhe a është bërë verifikimi i këtij personi si dhe a jeton ai person në territorin e Komunës së Podujevës, e them këtë për arsye se në nenin në vazhdim të Udhëzimit të cekur thuhet se Kryetari i Komunës përmes mediave kërkon nga Komunitetet të bëjnë propozimet, në këtë rast, propozimi nga Gazetarët, nga OJQ-të, nga Bizneset, dhe në rast se përfaqësuesit e Komuniteteve prej nga vijnë e kanë pëlqimin, ne e përkrahim, por ashtu siç e ceka më parë lidhur me personin numër 4 në propozim vendim, dëshirojmë të jemi të njoftuar se a i plotëson të gjitha ato që i ceka dhe që parashihen me Udhëzim Administrativ, e nëse jo atëherë mendoj se nuk duhet ta votojmë këtë person në përbërje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne në KPF debatuar bukur gjatë për këtë çështje dhe unë ju bëra me dije se kush është i interesuar, në Zyrën ligjore të Komunës mund të marrin Udhëzimin Administrativ përkatës dhe mund të shohin bazën e delegimit të përfaqësuesve të Komuniteteve të cekura, ku të gjitha ato propozime janë në formë të shkruar, mirëpo sa i përket komunitetit serb jam në dijeni se ai person që nga pas lufta ka qenë çdo herë përfaqësues i Komitetit dhe Këshillave të ndryshme të Komunës, dhe se i njëjti banon në lagjen e Sekiraqëve të fshatit Metergoc ku janë 7 - 8 banorë në atë lagje, kështu që as nga ndërkombëtarët por as nga vendorët nuk ka pasur ndonjë vërejtje.

z. Kadri Avdiu, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim mendoj se këtu nuk është duke u debatuar se a duhet të themelohet ky Këshill apo jo, por këtu na dolën disa kërkesa dhe vërejtje sepse duhet të respektojmë rendin dhe ligjin, ndërsa sa i përket asaj se a është punuar deri më tani nga KKS-ja që nga pas lufta, a ka qenë i themeluar dhe a ka raportuar, ne jemi në dijeni për këtë, ku sipas mendimit tim ky këshill nuk ka qenë në nivel. Këtu nuk janë kontestuese pozita e kryetarit të Komunës apo Komandantit të Stacionit të Policisë dhe disa pozita tjera të cilat përcaktohen me Udhëzim Administrativ, mirëpo këtu u paraqiten disa kërkesa se përfaqësuesit e Komuniteteve a kanë aplikuar, ai kanë propozimet e tyre me shkrim si dhe atë që e përmendi z. Haki Rudari e që ka të bëjë me përfaqësuesin e Komunitetit serb, se a jeton në territorin e Komunës së Podujevës, a është qytetar i Republikës së Kosovës, prandaj ne duhet të kemi arsyetim në formë të shkruar e jo vetëm arsyeime verbale. Pra ne nuk jemi për mos themelimin e këtij Këshilli, por jemi që ky këshill të jetë funksional dhe raportues para kuvendit e jo t'i mbyll sytë para opinionit për sigurinë faktike që e kemi në Komunën tonë që do të thotë se nuk është mirë.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, sa unë jam dijeni, të gjitha procedurat të cilat i parasheh Udhëzimi Administrativ përkatës janë respektuar për të marrë vendim Kuvendi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili është një trup mjaft i rëndësishëm.

Shumica e anëtarëve në përbërjen e KKS-së vijnë sipas detyrës zyrtare të përcaktuara në Udhëzim, ndërsa për anëtarët tjerë dëshiroj t'ju njoftoj se ne u kemi bërë ftesat me

shkrim të gjitha komuniteteve dhe organizatave të cilat jetojnë dhe veprojnë në territorin e Komunës së Podujevës të cilat i'u kanë përgjigjur ftesës dhe i kanë bërë propozimet e tyre në formë të shkruar, propozime të cilat secili prej jush mund të shikoi në Zyrën ligjore. Ky vendim nuk është që merret një herë dhe nuk mund të ndryshohet më, ngase secila shoqatë dhe secili grupacion në momentin që e vlerësojnë se duhet të bëhet ndonjë ndërrim mund të kërkojnë të kërkojnë iniciimin e procedurës përkatëse, e them këtë ngase ne i kemi respektuar procedurat ashtu siç përcaktohen me Udhëzim Administrativ përkatës, atëherë ato shoqata dhe ato komunitete mund t'i ngritin dhe t'i rishqyrtojnë propozimet e tyre dhe në çdo moment mund të tërheqin ndonjë emër dhe të bëjnë propozimin e ndonjë emri tjetër dhe sigurisht se ne do ta ndryshojmë vendimin në Kuvend sepse kështu parashihet. Ndërsa sa i përket çështjes që u ngrit për përfaqësuesin e komunitetit serb, sa unë jam në dijeni ai person është banor i Komunës së Podujevës dhe se ky Kuvend posa mori vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete ku anëtar nga komuniteti serb ishte edhe personi i njëjtë i cili u emërua anëtar nga komuniteti serb në atë Komitet, por nëse vërtetohet se personi në fjalë nuk është banorë i Komunës së Podujevës, ne këtë çështje mund ta shqyrtojmë në një prej mbledhjeve të ardhshme pa kurrfarë problemi. Kështu që ju bëjë thirrje të votoni këtë propozim vendim në mënyrë që mos të vonohemi në këtë drejtim ngase Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës është i obliguar t'i mbajë 6 mbledhje brenda 1 viti, ndërsa ne jemi në muajin e tretë dhe ende nuk jemi takuar, kështu që do të ishte mirë që të themelohej sot ky Këshill dhe mos të zvarritet, por nëse dëshironi ju si Kuvend mund të miratoni me vërejtje që nëse ndokush kur të dojë, çfarëdo OJQ-je apo Komuniteti të kërkon të bëjë zëvendësime, ne do të jemi të hapur për këtë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës besoj se të gjitha i sqaroj shumë qartë Kryetari i Komunës, dhe nuk e besoj se ka nevojë të ketë sqarime tjera rreth kësaj çështjeje.

z. Naim Çunaku, theksoi, nuk e mora fjalën të bëjë vërejtje, por forma e udhëheqjes së mbledhjes nga ju zotëri Kryesues më bëri ta bëjë atë ngase nuk është në kompetencën e juaj të thoni se a ka apo nuk ka nevojë të shprehi mendimin tim sepse kjo është e drejtë e imja që për një pikë të rendit të ditës të marr fjalën dhe të debatoj, andaj tu kisha lutur zotëri Kryesues se nëse kërkoj fjalën herëve tjera të mos përsëritet kjo.

Pas gjithë atyre sqarimeve dhe kërkesave që u bënë në lidhje me KKSB-në unë mora fjalën me qëllim që t'i kontribuoj gjithë asaj rreth themelimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, duke marrë për bazë gjithë atë çka e tha Kryetari i Komunës, që çdo këshilltar i Kuvendit ta ketë të drejtën që nëse gjenë ndonjë defekt apo vërejtje rreth propozimit të kandidatëve që nuk kanë ardhur në formë ligjore, të kontestohet dhe të mund të ndryshohet aj emër.

Jam në dijeni se ligji e përcakton që Kryetari i Komunës bënë thirrje përmes mediave që Komunitetet të cilat e kanë të drejtën me pas përfaqësuesin e tyre në këtë Këshill, ta propozojnë kandidatin e tyre.

z. Bahri Selimi, theksoi, lidhur me përfaqësuesin e komunitetit serb, me sa unë e vërejtja Kryetarin e Komunës gjatë arsyetimit të tij nuk ishte i sigurt se ky person është apo nuk është banor i Komunës së Podujevës, pasi që ai e tha, mendoj se është, e them këtë ngase konsideroj se nuk e është argumentuar, prandaj ne vetëm po kërkojmë që ajo të argumentohet dhe se nuk jemi kudër këtyre emrave por vetëm na intereson mënyra e delegimit të përfaqësuesve, ndërsa për përfaqësuesin e komunitetit serb është mirë që të

vërtetohet me dokumente që është banor i Komunës së Podujevës e pastaj shumë lehtë do të mund të merrej vendimi, edhe nëse në atë pjesë jetojnë 7 – 8 banorë serb le ta bëjnë konfirmimin e tyre se a janë banorë të Komunës së Podujevës dhe të propozojnë përfaqësuesin e tyre në KKSBB.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, unë e thash dhe po e përsërisë, sa unë jam në dijeni dhe sa unë kam informacione nga Komisioni Komunal i regjistrimit të popullsisë, Komisioni i cili gjatë regjistrimit të popullsisë ka shkuar në atë fshat kufitar ku personi në fjalë i është përgjigjur regjistrimit, që do të thotë se është regjistruar dhe është banor i Komunës së Podujevës, ndërsa për shtetësi tjera nuk jam në dijeni se a posedon apo nuk posedon ai person.

z. Vehbi Rushiti, theksoi, sa i përket çështjes së përfaqësuesit të komunitetit serb i cili jeton në lagjen e Sekirave të fshatit Metergoc, gjatë një mandati sa isha në Komitetin për Komunitete, anëtar nga komuniteti serb e kemi pasur një person nga Kushumlia e Serbisë i cili për dy vite me radhë i kemi bërë thirrje dhe ftesa, po ashtu ka shkuar edhe KFOR-i për ta transportuar, por asnjëherë nuk ka ardhur për të marr pjesë në mbledhje, ndërsa sa i përket Radisav Perovićit, i cili është i propozuar nga komuniteti serb për anëtar të KKSBB-së ju njoftoj se pasi që përfaqësuesi i komunitetit serb i cili jetonte në Kushumli nuk donte të vinte në mbledhje të Komitetit për Komunitete atë e pati zëvendësuar ky person.

z. Haki Rudari, theksoi, dëshiroj që edhe një herë ta ngris këtë çështje dhe nuk e bëjë këtë vetëm sa për të thënë se po debatoj diçka, por mendoj se së pari anëtarët –kolegët nga radhët e LDK-së mund t'i pyesin qytetarët se kush është ai njeri, ku jeton, a jeton në territorin e Komunës së Podujevës, a posedon dokumentacion, ashtu siç na i bëjnë neve qytetarët këto pyetje, e them këtë ngase ne kemi ardhur me vota të qytetarëve dhe për ata kemi detyrim ndaj qytetarëve. Ne nuk jemi kundër këtij këshilli në parim por jemi kundër individëve sepse nuk kemi njohuri se kush janë këta njerëz dhe ku jetojnë, pra nuk është bërë verifikimi i tyre. Çështje tjetër është se ne nuk jemi kundër disa emërimeve që i përmendi Kryesuesi i Kuvendit si, Kryetari i Komunës, Komandanti i Stacionit të Policisë etj, sepse kjo është e gjitha në rregull, mirëpo konkretisht jemi kundër personit të ranguar në numrin 4 të propozim vendimit, dhe nëse është ashtu siç e tha Kryetari i Komunës se në Zyrën ligjore të Komunës janë të gjitha dokumentacionet, kërkojmë të na paraqiten ato dhe neve nuk na mbetet tjetër përveç që ta votojmë, por nëse nuk na paraqiten ne do të votojmë kundër këtij propozim vendimi.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se ne tani e kemi shumë të qartë këtë çështje dhe se nëse në të ardhmen na paraqiten probleme apo vërejtje për të cilat mund të konstatohet se është ashtu, ne do t'i bëjmë ndryshimet. Para se të hedh në votim këtë propozim vendim dua t'ju njoftoj se nga OJQ "Hendikos" kemi pasur një ndryshim ngase kjo Organizatë pasi që ka propozuar z. Xhevat Kapitin e ka ndryshuar propozimin e vet dhe e ka propozuar z. Idriz Hoxhën për përfaqësues në KKSBB.

Pas votimit u konstatua se me 32 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozimi i këtij vendimi me vërejtje që nëse në të ardhmen vërehen përfaqësime jo ligjore nga komunitetet dhe OJQ-të tjera ky vendim mund të ndryshohet.

6. Propozimi i Vendimit për themelimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ne kemi diskutuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për miratim me propozim që anëtar të komisionit të cekur nga përfaqësuesit e subjekteve politike në Kuvend, të jenë: z. Agron Hyseni, anëtar nga radhët e LDK-së, z. Naim Çunaku, anëtar nga radhët e PDK-së, ndërsa nga radhët e LVV-së luteni të propozoni një anëtar.

z. Haki Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së për anëtar të komisionit përkatës, propozon z. Bahri Selimin.

Pas votimit u konstatua se me 34 vota për, 1 votë të përmbajtur dhe asnjë votë kundër, u miratua propozimi i vendimit për themelimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim, në këtë përbërje;

Abaz Llughaliu,	kryesues, përfaqësues i Ekzekutivit
Vezir Januzi,	anëtar, përfaqësues i Ekzekutivit
Faik Muçiqi,	anëtar, përfaqësues i Ekzekutivit
Agron Hyseni,	anëtar, përfaqësues i Kuvendit
Naim Çunaku,	anëtar, përfaqësues i Kuvendit
Bahri Selimi,	anëtar, përfaqësues i Kuvendit
Avni Shabani,	anëtar, përfaqësues i Shoqërisë civile

7. Propozimi i vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne për këtë pikë të rendit të ditës kemi diskutuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe jemi pajtuar me këtë propozim me disa vlerësime të cilat i gjeni në konstatime, ku i'u është rekomanduar Kuvendit për miratim dhe njëkohësisht obligohet Kuvendi i Komunës që deri në muajin tetor të këtij viti të formon një komision për hartimin e planit punues për vitin e ardhshëm duke u bazuar edhe në udhëzuesin përkatës të USAID-it.

z. Naim Çunaku, theksoi, është një gjë e mirë që edhe vitin e kaluar por edhe në këtë vit po hartohet një orar i seancave të Kuvendit, mirëpo edhe atëherë edhe tani ka qenë dashtë që krahas orarit të hartohet edhe plani i punës së Kuvendit të Komunës të cilit duhet t'i paraprijnë planet e Ekzekutivit në mënyrë që të harmonizohen kërkesat gjegjësisht nevojat e akteve që duhet të miratohen dhe të kalojnë përmes Kuvendit dhe me sugjerim gjegjësisht se po të kishim edhe planet e punës së Drejtorive përkatëse sigurisht se do të harmonizonim dhe do të nxjerrshim një plan të punës së Kuvendit dhe si i tillë mendoj se do të na rritke respektin dhe do të ishim në një nivel të detyrës çfarë e kërkojnë normat e vendimmarrjes së Kuvendit Komunal. Ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa u morëm vesh që në një të ardhme të afërt Drejtoritë Komunale t'i bëjnë planet e punës dhe atëherë kur t'i kemi për bazë planet e punës së Drejtorive ne Kuvend do ta formojmë një komision dhe do të hartojmë një plan të punës

së Kuvendit. Pra orarin e takimeve e mbështesim, por presim që të plotësohet edhe me planin e punës së Kuvendit.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse nuk kemi diskutime të tjera për këtë pikë të rendit të ditës e hedh në votim këtë propozim me vërejtjet që i dha parafolësi, që më së largu deri në tetor 2014 të ngritët një Komision për përgatitjen e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2015 dhe të miratohet deri në fund të këtij viti.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i këtij vendimi

8. Propozimi i vendimit për mbështetje financiare OJQ – në Hendikos – Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi në Podujevë

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në bazë të kërkesës së OJQ – ‘Handikos’, ne kemi proceduar këtë propozim vendim, dhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa pas debatit, njëzëri i kemi rekomanduar Kuvendit për miratim.

z. Kadri Avdiu, theksoi, ne një ditë më parë në mbledhjen e KPF-së e kemi diskutuar këtë çështje dhe përveç disa kërkesave që dolën në atë mbledhje të cilat realisht kishin të bënin me informim, ne shprehëm dyshimin se a është e mjaftueshme ajo shumë e mjeteve për OJQ ‘Handikos’ sepse ne jemi në dijeni se ajo Organizatë është e nevojshme dhe duhet të ndihmohet, andaj ne e mbështesim këtë propozim vendim sepse ata persona kanë nevojë të mbështetën edhe më shumë, mirëpo kërkesat që dolën ishin që në atë Organizatë të përfshihen të gjitha rastet, kërkesë për të cilën edhe ne e mbështesim dhe njëkohësisht e lusim atë Organizatë që të përfshihen të gjitha rastet dhe mos të mbetet asnjë person pa u përfshi në aktivitetet dhe ndihmat tjera të ‘Hendikosit’.

z. Bahri Selimi, theksoi, Grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje e mbështet këtë propozim vendim dhe kërkojmë që të jemi sa më afër atyre personave por edhe personave tjerë me nevoja të veçanta.

z. Islam Revuçi, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit politik LDK e ka shqyrtuar propozimin e vendimit përkatës dhe ne plotësisht e mbështesim këtë, mirëpo unë e mora fjalën me të vetmin qëllim të sugjeroj që Ekzekutivi i Komunës në krye me Kryetarin e Komunës të gjejnë edhe forma tjera për bashkëpunim dhe përkrahje të kësaj Organizate.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, pa asnjë dyshim e mbështesim këtë propozim vendim për mbështetje OJQ-në ‘Hendikos’ dhe konsiderojmë që këtë Organizatë duhet ta mbështesim edhe në projekte tjera të veçanta për plotësimin e nevojave të tyre sepse kjo mbështetje financiare ashtu siç duket nga plani i tyre i mbulon nevojat e funksionimit të saj, mirëpo jo edhe krijimin e kushteve më të mira të këtyre personave.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim i vendimit

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me komisionin për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit dua të ju njoftoj se ky komision ka qenë i themeluar në këtë përbërje; z. Afrim Shabani, anëtar nga radhët e LDK – së, z. Flakron Gashi, anëtar nga radhët e PDK – së, dhe z. Haki Rudari, anëtar nga radhët e LVV –

së, mirëpo meqë në mbledhjen e kaluar nuk është konstatuar si i miratuar dhe me mandat të njëjtë me atë të Kuvendit të Komunës, konsideroj se është e nevojshme që sot konstatohet.

Pas votimit njëzëri u konstatua miratimi i vendimit për themelimin e këtij komisioni, në këtë përbërje:

Afrim Shabani, anëtar nga radhët e LDK – së
Flakron Gashi, anëtar nga radhët e PDK – së, dhe
Haki Rudari, anëtar nga radhët e LVV – së

9. Të ndryshme

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, dëshiroj të ju njoftojë se nesër mbahet Kuvendi zgjedhor i Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe ky asociacion ka kërkuar nga Komuna e Podujevës gjegjësisht nga Kuvendi i Komunës që të miratoj vendimin për përfaqësim të Komunës së Podujevës në AKK. Ne në Komitetin për Politikë dhe Financa jemi pajtuar dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për miratim të këtij vendimi që përveç, z. Agim Veliu Kryetari i Komunës, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës së Podujevës të jenë; Mehmet Gashi, në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit, Liridona Shabani, nga radhët e LDK-së, Kadri Avdiu, nga radhët e PDK-së dhe Haki Rudari nga radhët e LVV-së.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim vendim sipas rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, në këtë përbërje:

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës
z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
z. Liridona Shabani, anëtare nga radhët e LDK-së
z. Kadri Avdiu, anëtar nga radhët e PDK-së, dhe
z. Haki Rudari, anëtar nga radhët e LVV-së

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, në vazhdim i ftojë anëtarët që të jenë prezent nesër në orën 9:00 të mëngjesit në autoparkun e Komunës prej nga edhe do të bëhet nisja për pjesëmarrje në takimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

z. Flakron Gashi, theksoi, të gjithë ne jemi në dijeni se organet komunale nxjerrin një buletin informativ, kushtimisht po e quaj informativ ngase ai paguhet me taksa të qytetarëve, dua të ndërlidhem me numrin 2 të këtij buletini i cili është nxjerrë në muajin shkurt 2014, unë këtë buletin e quaj dezinformativ, jo me dashje, sepse paguhet me taksa të qytetarëve gjegjësisht me paranë publike.

Po ndërlidhem me titullin ku thotë, u mbajt mbledhja e tretë e Kuvendit dhe ku sqarohet se si është thirrur seanca e tretë e rregullt dhe cilësohet se kryesohet nga z. Mehmet Gashi gjë që këtë askush nuk e vë në mëdyshje, mandej thuhet se në këtë mbledhje Kuvendi miratoj rendin e propozuar të ditës, por mos të harrojmë se ky rend dite i

nderuari Kryesues nuk është miratuar sepse këtu në këtë buletin janë cekur edhe dy pikat e rendi të ditës që nuk janë miratuar, e to ato ishin,

-propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesave të Smajl Latifit nga fshati Majac dhe Fexhri Sylës nga fshati Gllamnik, dhe

-propozimi i vendimit për lejimin e shpërndarjes së masës drusore për djegie, të konfiskuara për shkak të prerjes pa leje.

I nderuari Kryesues ju shumë mirë jeni në dijeni se këto dy pika të rendit të ditës janë kundërshtuar dhe janë konsideruar si jo ligjore dhe se pas pauzës prej 10 minutave këto pika të rendi të ditës janë hequr nga rendi i ditës, prandaj nuk është e vërtetë se ai rend i ditës i propozuar për mbledhjen e 21 shkurtit 2014 është miratuar ashtu siç thuhet në këtë buletin.

Çështje tjetër të cilën dua ta them është se të nderuar kolegë ne jemi në dijeni se me dashje apo pa dashje pjesë e organeve komunale është edhe opozita, prandaj këtë buletin shihen qartë artikuj dhe aktivitete të shumta për 6 vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Këtu thuhet se Kryetari i Komunës z. Agim Velu se bashku me ekipin apo stafin e tij bënë homazhe te varrezat e dëshmorëve, ndërsa në foto shihen edhe tri figura përkatësisht shefi i Grupit të këshilltarëve të PDK-së dhe dy këshilltar tjerë nga opozita, ku asnjërit prej tyre nuk iu përmendet emri fare. Unë mendoj se paraja e qytetarëve duhet të reflektoj aktivitetet si të pozitës ashtu edhe të opozitës sepse edhe ne si opozitë jemi institucione, prandaj unë mendoj se pavarësisht se ky buletin quhet informativ është dezinformativ.

Po e ndërlidhi me fjalën tënde zotëri Kryesues i Kuvendit që në fillim na përshëndete duke na thënë se është mirë të reflektojmë drejtë sepse këto mbledhje incizohen dhe përcillen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, unë të pyes ty i nderuari Kryesues se si mund të dalësh më mirë se të mbrosh ligjshmërinë ku ne i kemi mbrojtur dy pika të ligjshmërisë ku kemi kërkuar të hiqen nga rendi i ditës, gjithashtu të sugjeroj se ju jeni Kryesues i asamblesë dhe asambleja përbëhet nga asamblist të pozitës dhe të opozitës dhe ajo praktik se çka të flitet dhe si të flitet ka qenë vetëm në partin e punës dhe falë Zotit ajo kohë ka kaluar, prandaj unë në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së sugjeroj që në të ardhmen Kuvendi i Komunës të shqyrtoj mundësinë që seancat në asamblenë Komunale të transmetohen drejtpërdrejt përmes dy radiove lokale.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, duke iu përgjigjur parafolësit theksoi, dua të jap një sqarim, unë nuk e kam lexuar dhe nuk di se çfarë thuhet në atë buletin, mirëpo në mbledhjen e ardhshme bëhet miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar dhe aty mund të jepni vërejtje nëse ka diçka që nuk ka qenë ashtu, ndërsa sa i përket atyre dy pikave që u përmenden është e vërtetë se ne i kemi hequr ato pika nga rendi i ditës në një marrëveshje me shefat e Grupeve të këshilltarëve, ndërsa rendin e ditës me pikat tjera e kemi miratuar e që jemi duke vazhduar edhe sot me atë rend dite.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, për shkak të transparencës, sepse fundja është se në të gjithë i kemi premtuar shumë elektoratit tonë, kërkoj dhe insisto që seancat e Kuvendit të Komunës të transmetohen drejtpërdrejt të paktën në këto dy radio lokale dhe se ky Kuvend të bëjë marrëveshje ose të lidhë kontrata me ato radio për transmetimin e seancave të Kuvendit në mënyrë që qytetarët tanë të jenë të informuar për zhvillimet dhe ngjarjet që ndodhin këtu, çështja e dytë është se unë jam në dijeni se

seancat kanë audioincizim dhe që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i përcjell këto mbledhje, mirëpo ju nuk na keni informuar ndonjëherë dhe nuk jam në dijeni se a ka edhe videoincizim, e nëse ka do të kishte qenë shumë mirë që në ueb - faqen zyrtare të Komunës të plasoj ato videoincizime ku qytetarët do të mund t'i shikonin të gjitha angazhimet e Kuvendit dhe të të gjithë këshilltarëve.

Çështja e tretë që dua të them ka të bëjë me ju zotëri Kryesues, në këtë kohë të parafushtës, ngase me gjasë në këtë vit do të mbahen zgjedhjet nacionale, Qeveria e Kosovës bëri një hap të mirë që i rriti pagat, mirëpo si kategori të përjashtuar na ka lënë neve si asamblastë të Kuvendeve Komunale gjë për të cilën kërkoj nga ju zotëri Kryesues se do të ishte mirë ta inicioni dhe të insistoni në Asociacionin e Komunave të Kosovës që pagat e asamblastëve të Komunave të Kosovës të rriten sepse fundja është shumë nënçmuese dhe fyese për një asamblast që është përfaqësues i qytetarëve ta ketë bazën e pagës 100 €.

z. Flakron Gashi, theksoi, Kryesuesi kuvendit e tha se në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës e kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar dhe mund të bëni vërejtje dhe korrigjime, por unë them se mos të harrojmë se ai artikull në atë buletin tani veç ka dalë dhe qytetarët janë të njoftuar për këtë. Në atë artikull ceket se në vazhdim u procedua me propozimin e vendimit për themelimin e Komiteteve dhe Komisioneve tjera të Kuvendit, dhe që themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa është themeluar pas pauzës prej 10 minutave atëherë sikur të kish qenë e vëmendshme dhe mos të lëshohej kjo me qëllim do të mund të evitoheshin edhe dy pikat e hequra nga rendi i ditës pas asaj pauze. Gjithashtu ka mundur të ceket edhe kërkesa e grupit të këshilltarëve të PDK-së e mbështetur edhe nga partitë tjera opozitare për ngritjen si pikë të rendit të ditës çështjen e obeliskut të Heroit "Afrim Zhitia", e kjo nuk ka ndodhur. Prandaj unë edhe njëherë ju lus zotëri Kryesues që meqë Komuna dhe çdo institucion tjetër shtetëror paguhen dhe zhvillohen me financa të qytetarëve e që është paraja publike, të shërbej për informim të qytetarëve e jo për dezinformim.

z. Bahri Selimi, theksoi, mora fjalën të japë një rezymë të shkurtë rreth seancave të Kuvendit të Komunës të cilat p mbahen, edhe ne pajtohemi me atë se informimi nga ana e Komunës nuk është shumë i sakët dhe nuk është shumë informues për qytetarët, kësaj i referohem gjithëherë ueb-faqes së Komunës së Podujevës në të cilën për të gjitha seancat bëhen shkrime shumë të shkurtra, dhe ne përveç asaj që jemi për transmetimin e drejtpërdrejt të seancave të Kuvendit në dy radiot lokale, ngase fatkeqësisht televizion lokal ne nuk kemi si Komunë, dhe kërkojmë nga Komuna që incizimi i seancave të Kuvendit të bëhet me videoincizim dhe të futen ato videoincizime në ueb-faqen e Komunës në mënyrë që qytetarët e komunës së Podujevës të jenë më të informuar për punën e Kuvendit të Komunës. Pra me fjalë tjera të kenë mundësi qytetarët t'i shikojnë dhe dëgjojnë çdo mbledhje të Kuvendit, e jo vetëm t'i lexojnë ato.

z. Fidan Rekalu, theksoi, ne këshilltarët e Kuvendit të Komunës nga radhët e subjektit politikë LDK edhe në mandatin e kaluar e kemi përkrahur iniciativën që seancat e Kuvendit të Komunës të përcillen nga mediat qofshin ato lokale apo qendrore, mirëpo ne askujt nuk mundemi t'ia imponojmë që të vie dhe ti përcjell këto seanca, por e përkrahim dhe jemi të hapur në mënyrë që qytetarët tanë të jenë më të informuar për punën e Kuvendit të Komunës së Podujevës.

z. Naim Çunaku, theksoi, ajo çka u potencua tani, mua më duket se e kemi përmendur në mandatin e kaluar dhe po e përmendim edhe tani, me këtë dua të them atë që është propozuar në Kuvend dhe që nuk është bërë. Unë jam në dijeni se ekziston vullneti nga ana e mediave, mirëpo kërkesa ka qenë që Kuvendi Komunal të ndaj mjete nga buxheti i Komunës dhe të tenderoj stacione lokale qoftë edhe ato tjera që kanë vullnet dhe interesim që ta bëjnë transmetimin e drejtpërdrejt të seancave të Kuvendit ose të paktën ta bëjnë atë që e tha kolegu nga radhët e LVV-së, ne nuk kemi thënë dhe nuk po merremi me vullnetin e mediave por po kërkojmë që të ndahen mjete dhe të tenderohen media lokale për përcjelljen e seancave të Kuvendit të Komunës e nëse ato media nuk kanë interesim do të gjenden medime tjera të cilat kanë interesim për prezantimin e mbledhjeve të Kuvendit, pra vetëm në këtë formë mund ta bëjmë publike atë se çka thuhet në Kuvend dhe të ofrojmë më shumë qytetarët në vendimmarrje gjegjësisht të njoftojmë qytetarët për debatet që zhvillohen në Kuvend.

z. Bahri Selimi, theksoi, dëshiroj të bëjë një arsyetim të shkurtë, këtu u përmend vullneti gjë për të cilën nuk mendoj se është çështje vullneti te mediat lokale ashtu siç e tha edhe parafolësi por është çështja për një marrëveshje të përbashkët në mënyrë të kompensimit, mirëpo transmetimi i audioincizimit në ueb faqe të Komunës është vullnet i yni personal sepse kjo faqe mirëmbahet nga Komuna e Podujevës e jo nga mediumet, prandaj ky vullnet duhet të jetë nga Kuvendi Komunal dhe Kuvendi ta bëjë atë.

Pra ne kërkojmë që në ueb faqen e Komunës së Podujevës të futen edhe incizimet e mbledhjeve të Kuvendit në audioincizimeve.

z. Mehmet, Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nga ky debat dolën edhe disa propozime të cilat do t'i kemi parasysh ne dhe Ekzekutivi i Komunës ndërsa lidhur me çështjen të cilën e ngriti z. Lutfi Rexhepi rreth ngritjes së pagave të këshilltarëve të Kuvendeve Komunale, unë t'ju them të drejtën nuk jam në dijeni se a u është rritur apo jo paga e këshilltarëve por ju them se këtë çështje do të shtrojmë në Asociacionin e Komunave të Kosovës që në rritjen e pagave të përfshihen edhe këshilltarët e Kuvendeve Komunale.

Para se të përfundojmë këtë mbledhje dua t'ju njoftoj se deklarimi i pasurisë së këshilltarëve të Kuvendit mund të bëhet deri më 31 mars 2014.

Mbledhja përfundoi në orën 11.05'

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr. 01-006-28403
Podujevë,
21 shkurt 2014 – 13 mars 2014

Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi